

STATUTI
I SHOQERISË' ME PËRGJEGJËSITË KUFIZUAR
SCK CERTS ALBANIA SH.P.K.

Sot ,më 12/ 12/2024, në bazë të Kushtetutës dhe të Kodit Civil në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në bazë të ligjit në fuqi Nr.7512 ,datë 08.10.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private Sipërmarrjeve të lira dhe aktiveve private dhe privatizimit” të ligjit Nr.9901,datë 14.04.2008, “Për marrëdhëniet tregtare” dhe në bazë të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të regjistrimeve të Biznesit” ,që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare,me vullnetin e saj të lirë ,nënshkruan këtë Statut,i cili vlen dhe si Akt Themelimi:

Paola Pisano lindur më 25/04/1984 , në Napoli ,Itali ,me numër dokumenti **YC0740241** e cila ka vendosur të hartohet Statuti i një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, aktiviteti i së cilës do të rregullohet mbi bazën e Legjislacionit Shqiptar në fuqi, sipas Akt Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë bashkëngjitur.

Neni 1 – Emërtimi

1.1 Emërtimi i Shoqërisë është **SCK CERTS ALBANIA** (e cilësuar më poshtë si “Shoqëria”)

Neni 2 – Forma ligjore

2.1 Shoqëria **SCK CERTS ALBANIA** është e themeluar si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe është e rregulluar sipas Statutit të saj si më poshtë vijon,dhe ka vlerë në bazë të Legjislacionit Shqiptar në fuqi dhe si Akt Themelimi.

2.2 Shoqëria operon në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi.

Neni 3 – Selia

3.1 Shoqëria operon me seli në adresën:TIRANE Rruga "Donika Kastrioti", pranë Ambasadës Zvicerane, Kati i Katërt, Nr.24.

3.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, përfaqësi dhe agjensi si brenda Shqipërisë ashtu edhe jashtë shtetit Shqiptar.

3.3 Mbledhja e Ortakëve,mund të vendosë, transferojë dhe/ose të mbyllë, si brenda edhe jashtë shtetit Shqiptar, degë sekondare, filiale,seli, agjensi, zyra përfaqësimi dhe bashkësi lokale të çdo natyre.

Neni 4 – Objekti

Shoqëria ka për qëllim të saj çdo veprim të ligjshëm tregtar, pa kufizim në aktivitetet e renditura më poshtë:

- Aktivitetet e certifikimeve, Konulencave dhe verifikimeve të sistemeve të menaxhimit të cilësisë dhe/ose mjedisit dhe/ose sigurisë dhe shëndetit të punonjësve në bazë të të gjitha standardeve dhe direktivave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe në përputhje me çdo standard tjetër të certifikimit të sistemeve të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe/ose sigurisë së punonjësve, kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe trajnimin përkatës në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën përkatëse;
- Aktiviteti i inspektimit, vlerësimit të përputhshmërisë, verifikimit teknik, kontrollit të cilësisë, sigurisë dhe qëndrueshmërisë në kuptimin më të gjerë të saj dhe certifikimit, si një palë e pavarur që vepron në emër të organizatave nga të gjitha sektorët ekonomikë, sipërmarrëse dhe shoqërorë, me fokus të veçantë, por jo të kufizuar, në tregti, industri, inxhinieri, turizëm, ushqimore, agro-ushqimore, agro-industrial, shërbime të avancuara, transport, ndërtim, komunikime, informatikë, shërbime publike dhe private, në tipologji të ndryshme, qëllime dhe karakteristika, e lidhur gjithashtu me : sistemet e menaxhimeve të biznesit, lëndët e para dhe materialet, produktet gjysmë të gatshme dhe të përfunduara, proceset dhe metodat e prodhimit, komponentët, pajisjet, veglat, makineritë, punonjësit profesionistë, Prezantimin e shërbimeve të cdo lloji tipologjie ose qëllimi, qoftë në fushën e legjislacionit të detyrueshëm ose të rregulluar, në përputhje me normat dhe standardet dhe specifikimet teknike ndërkombëtare, europiane dhe kombëtare dhe çdo lloj dokumenti të natyrës detyruese, si dhe direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian dhe legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, po ashtu në fushën vullnetariste dhe kontraktuale, në përputhje me rregulloret ose skemat e normave vullnetariste ose pronësore ose të pranuar nga palët e interesuara, gjithashtu në formën e udhëzimeve ose rekomandimeve, për qëllimin e lëshimit të certifikatave, deklaratave përputhshmërie, raporteve të inspektimit dhe vlerësimit, gjithashtu për qëllimin e miratimit të produkteve, makinerive dhe impianteve për markimin CE ose për vendosjen e markave të tjera të detyrueshme ose vullnetare;
- Rrjetet e furnizimit përmes kontrollit dhe lëshimit të mostravave, prototipave dhe furnizimeve në seri, si dhe përmes kualifikimit të furintoreve, përfshirë miratimin e planeve të cilësisë dhe mbikëqyrjes përkatëse me veprime monitorimi dhe përmirësimi të performancës në përputhje me planet e furnizimit të porositësve dhe modelët e menaxhimit të njohura dhe çdo kërkesë tjetër detyruese, rregullative dhe kontraktuale të aplikueshme, gjithashtu të tipologjise "mystery client" dhe/ose "mystery audit";
- Shërbime në sektorin mjedisor përfshirë verifikimin dhe rishikimin e vlerësimit të ndikimit mjedisor fillestar dhe realizimin e inspektimeve dhe kontrolleve prane selive të interesuara të cilat kanë ndikim të lartë në ekosistemin, si dhe realizimin e kërkimeve dhe mbledhjen e të dhënave dhe mostrave të faktorëve mjedisorë;
- Krijimi, menaxhimi, kontrolli i markave që dëshmojnë përputhshmërinë e produkteve, shërbimeve dhe proceseve, sipas normave vullnetare ose të detyruara ;

- Certifikimi i personelit, si në përputhje me normat teknike që rregullojnë kërkesat për profesionistët, ashtu edhe përmes rregulloreve ose skemave të hartuara ad-hoc;
- Planifikimi i sigurisë dhe parandalimi i aksidentëve në vendin e punës, sipas normave kombëtare, ndërkombëtare dhe komunitare;
- Aktivitetet e validimit të projekteve për realizimin e punëve publike.

Për të arritur qëllimin e saj shoqëria mund, në përputhje të plotë me legjislacionin aktual, të kryejë çdo veprimtari të lidhur drejtpërdrejtë me ato të parashikuara si mision të saj në këtë nen, dhe në veçanti të kryejë çdo veprimtari të letrave me vlerë, pasuri të paluajtshme, tregtare, industriale dhe transaksionet financiare, investime të kapitalit, të bashkëpunoj ose blej aksione në kompani të tjera shqiptare ose të huaja, të zhvilloj bashkëpunime ose të bëjë marrëveshje me institucione të tjera publike ose private, kishtare ose civile, si shqiptare ashtu edhe të huaja, të cilat kanë qëllime të njejta ose të ngjashme me ato të shoqërisë;

Mund të marrë kredi dhe në përgjithësi të përdorë çdo formë të financimit si për grantet me institucionet shtetërore ashtu dhe ato të kreditit me bankat, kompanitë ose individët.

Shoqëria do të jetë në gjendje të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur dhe plotësues si ato të mësipërme që konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për arritjen e qëllimit të saj dhe realizimi i qëllimit të shoqërisë mund të ndiqet edhe përmes mjeteve të shitjes së disponueshme në treg si brenda ashtu dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Aktivitetet financiare të përjashtuara ose të rezervuara nga rregulloret ligjore aktuale janë të përjashtuara nga aktiviteti i shoqërisë.

Neni 5 – Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është vendosur deri më 2091 dhe mund të zgjatet.

Neni 6 – Kapitali

6.1. Kapitali është 10.000 (dhjetë mijë) lekë i përbërë nga 1 (një) kuotë e barazvlefshme me vlerë nominale përkatësisht 10.000 (dhjetë mijë) lekë të **Paola Pisano**.

6.2 Kapitali i shoqërisë është plotësisht i regjistruar dhe i lëshuar në mënyrën e mëposhtme:

Paola Pisano zotëron 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë i barazvlefshëm me 1(një) kuotë.

Neni 7 – Mundësia e transferimit të kuotave

7.1 Kuotat sociale janë të transferueshme tek palët e treta në përputhje me dispozitat e akteve nënligjore të parashikuara në STATUT.

Neni 8 – Administratorët

- 8.1 Shoqëria mund të administrohet nga një ose më shumë Administratorë, të lirë të veprojnë veçmas ose bashkarisht sipas asaj që do të vendoset në rastin e emërimit.
- 8.2 Administratorët nuk duhet të jenë medoemos edhe aksionerë dhe veprojnë në rolin e tyre derisa të japin dorëheqje ose shkarkohen nga Asambleja e Aksionerëve, ose për një periudhë pesë-vjeçare (5) me mundësinë për t'u riemëruar.
- 8.3 Përfundimi i mandatit të Administratorëve hyn në fuqi në momentin kur emërohet organi i ri administrues.
- 8.4 Administratorëve u takon të përfaqësojnë Shoqërinë ndaj palëve të treta dhe në gjykim dhe kompetencat më të gjëra administrative, që mund të ushtrohen në harmoni me atë që përcakton artikulli 95 i ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ndryshime pasuese, por në çdo rast, brenda kufijve të përcaktuar në rastin e emërimit dhe nga ky Statut.
- 8.5 Administratorët mund të emërojnë prokurë te veçantë për një akt ose një sërë aktesh.
- 8.6 Funkzioni administrativ kryhet sipas nje tarife të parashikuar në ligj. Administratorëve u takon rimbursimi i shpenzimeve që kanë lidhje me funksionin e tyre administrativ.
- 8.7 Me këtë akt themelimi vendosen si Administratorë të Shoqërisë:

Paola Pisano lindur më 25/04/1984, në Napoli ,Itali e bija e Goffredo Pisano , me numër dokumenti **YC0740241** me afat administrimi nga 12/12/2024 deri në 12/12/2029 dhe

Desjona Zeqo lindur më 19/10/1989, në Fier,Shqipëri,e bija e Ardian-it, me numër dokumenti **I96019041W** me afat administrimi nga 12/12/2024 deri në 31/12/2024

Artikull 9 – Gjuha

- 9.1 Ky Statut hartohet në gjashtë (6) kopje, tri (3) në gjuhën shqipe dhe tri (3) në gjuhën italiane.
- 9.2 Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin e këtij Statuti, versioni i tij në gjuhën italiane do të jetë i vetmi me vlerë të detyrueshme ligjor.
- 9.3 Ky akt miratohet në çdo artikull nga themeluesit e vetëm të Shoqërisë **SCK CERTS ALBANIA** i cili nënshkruan me emrin, mbiemrin dhe firmën e vet të gjitha kopjet.

* * *

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË
Paola Pisano

